

AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI I SHOQËRISË

“ALLKODOMI” SHPK

THEMELIMI

Neni 1
Ortaku themelues

1.1 Shoqëria “ALLKODOMI” SH.P.K. themelohet nga Ortaket:

Z. Giorgio Dominici shtetas italian, lindur më 07.01.1971 ne Albenga (SV), Itali, rezident ne Via Aquila 29, Orco Feglino (SV), Itali, mbajtes i Kartes ID me Nr. AO 9443789 me zotesi te plote per te vepruar,

Z. Petraq Allkollari shtetas shqiptar, lindur më 27.01.1963 ne Korce, Shqiperi, rezident ne Via Milano 22/2, Pietra Ligure (SV), Itali, mbajtes i Kartes ID me Nr. AV 2449893 me zotesi te plote per te vepruar,

EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE

Neni 2
Emërtimi

2.1 Emërtimi i shoqërisë është “ALLKODOMI” SH.P.K.

Neni 3
Forma ligjore

3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 4
Baza ligjore

4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Aktin e Themelimit, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.

Neni 5
Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1 Veprimtaria e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("QKB").
- 5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është i pacaktuar.

Neni 6
Selia

- 6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Rr. Besim Alla, Pall. Alfa, Hyrja 4, Dyqani nr.14, Yzberisht, Tirane
- 6.2 Shoqëria mund të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësimi si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.
- 6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

Neni 7
Emblema. Vula

- 7.1 Shoqëria do të ketë emblemen dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.
- 7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjisllacionit shqiptar.
- 7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përmbajnë emblemen dhe vulën e saj.

Neni 8
Objekti

- 8.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është:
- Shitje veshjesh dhe artikujsh te ndryshem me shumice e pakice
 - Menaxhim Call Center, Perpunim te dhenash per te trete, sherbim klienti, ofrime sherimesh te ndryshme per firma
 - Realizim sherbimesh fotografike dhe video
 - Prodhim veshmbathje
 - Aktivitet scouting ne fushen e modes dhe spektaklit.
 - Cdo aktivitet tjeter i lejuar nga ligji
- 8.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblese se Pergjithshme.

Neni 9 Kapitali

- 9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000 ALL (Dhjetë mijë ALL). Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e Shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
- Ortaku themelues **Z. Giorgio Dominici**: zotëruar i një quote me vlerë të përgjithshme **5000 ALL** (Pesë mijë leke) e cila përben **50%** të kapitalit themelues të Shoqërisë
- Ortaku themelues **Z. Petraq Allkollari**: zotëruar i një quote me vlerë të përgjithshme **5000 ALL** (Pesë mijë leke) e cila përben **50%** të kapitalit themelues të Shoqërisë
- 9.2 Kapitali është shlyer tërësisht.

Neni 10 Transferimi i pjesëve të kapitalit. Kufizimet.

- 10.1 Pjesët e kapitalit mund të transferohen tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” me amendimet përkatëse.
- 10.2 Vendosja e çfarëdolloj barre mbi pjesët e kapitalit në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 11 Rritja e kapitalit

- 11.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 11.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të tjera të kapitalit nga ortakët e rinj. Ortakët e rinj pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 12 Zvogëlimi i kapitalit

- 12.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni tregtar.
- 12.2 Propozimi i zvogëlimit do t'i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar dhe administratorit të paktën 45 ditë përpara marrjes së vendimit nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë. Eksperti kontabël dhe administratori do të shqyrtojnë

propozimin dhe do t'i paraqesin Asamblese se Pergjithshme raportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.

- 12.3 Raporti i zvogëlimit të kapitalit do të miratohet me vendim të Asamblese se Pergjithshme të shoqërisë.

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 13

Organi Vendimarrës

- 13.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë merren nga Asambleja e Pergjithshme e Shoqërisë.

- 13.2 Vendimet e Asamblese se Pergjithshme përfshijnë kryesisht:

- Ndryshimet e statutit
- Emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë;
- Emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar, në qoftë se është e nevojshme;
- Percaktimin e shperblimeve te administratorit/Administratoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- Ndryshimin e selisë ose të emërimit të shoqërisë;
- Rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
- Shitjen ose transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar palëve të treta;
- Prishjen dhe likuidimin e shoqërisë;
- Miratimin e bilancit të shoqërisë;
- Transformimin e shoqërisë në forma të tjera.

Neni 14

Administrimi

- 14.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator ose një grup administratorësh që caktohen me vendim të Asamblese se Pergjithshme.
- 14.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe drejtojë punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me udhëzimet e Asamblese se Pergjithshme.
- 14.3 Administratore te shoqërisë janë:

Z. Giorgio Dominici shtetas italian, lindur më 07.01.1971 ne Albenga (SV), Itali, rezident ne Via Aquila 29, Orco Feglino (SV), Itali, mbajtes i Kartes ID me Nr.AO 9443789.

Z. Petraq Allkollari shtetas shqiptar, lindur më 27.01.1963 ne Korce, Shqiperi, rezident ne Via Milano 22/2, Pietra Ligure (SV), Itali, mbajtes i Kartes ID me Nr. AV2449893,

14.4 Administratori është përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:

- Drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
- Përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose me përfaqësim;
- Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit;
- Përgatitjen e dokumentave në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zoteron;
- Të zhvillojë veprimtari të tjera të çdo lloj natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektit të saj.
- Administratori ka të drejtë për ta përfaqësuar shoqërinë në Shqipëri tek palët e treta, insitucione apo entitete publike ose private.
- Të lidhë, për dhe në emër të shoqërisë kontrata me palë të treta;
- Të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër që konsiderohet i nevojshëm për mbarëvajtjen e biznesit;
- Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri përpara bankave të nivelit të dytë dhe Bankes së Shqipërisë si dhe të kryej, në emër të shoqërisë cdo transaksion bankar në emër të shoqërisë.
- Të ndërmarrë çdo veprimtari tjetër ose biznes ose aktivitet, te hape dege ose zyre perfaqesimi, qe konsiderohen te nevojshëm për biznesin e shoqërisë.

14.5 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm për pesë vjet me të drejtë ripërtëritje ose deri në çastin e revokimit të tij me vendim të Asamblese se Pergjithshme.

Neni 15 **Viti financiar**

- 15.1 Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të cdo viti.
- 15.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Zyrën e Tatim Taksave dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

Neni 16
Bilanci. Kontabiliteti.

- 16.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Asambleja e Pergjithshme dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.
- 16.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave të legjislacionit përkatës. Për operacione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.
- 16.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Asamblese se Pergjithshme.

Neni 17
Te Ardhurat. Dividendi

- 17.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezervë për realizimin e qëllimeve të biznesit të saj në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 17.2 Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së cdo ushtrimori, pas pagimit të tatimeve, mund të ndahen ndërmjet ortakëve në raport më pjesët që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë.
- 17.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe çdo ortak do të pergjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimorit të parë deri në tre ushtrimorët vijues.

Neni 18
Likuidimi

- 18.1 Prishja e shoqërisë vendoset me vendimin e Asamblese se Pergjithshme.
- 18.2 Me vendimin e Asamblese se Pergjithshme caktohet një likuidator ose një grup likuidatorësh që do të plotësojnë procedurat e likuidimit.
- 18.3 Likuidatori do të përgatisë raportin e likuidimit mbi gjëndjen ekonomike të shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohën që nevojitet për përfundimin e tij. Në përfundim të kësaj procedure, Asambleja e Pergjithshme

do të shqyrtojë bilancin përfundimtar dhe do të miratojë përfundimin e procedurave të likuidimit.

Neni 19
Mosmarrëveshjet

- 19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

Tiranë, datë 03.12.2018

ORTAKET:

Z. Giorgio Dominici

Z. Petraq Allkollari

Përfaqësuar me prokurë dt.

Nr. 785 Rep dhe Nr.477/2 Kol.

Nga:

Znj. Enika Hajdari mbajtëse e Kartës së Identitetit nr.024499068

